



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI**

Në bazë të nenit 17 shkronja L të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, dhe nenit 19 shkronja L të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 01 qershor 2015, miratoi,

## **VENDIM**

### **PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE PËR BANIM SH. A. PODUJEVË**

#### **Neni 1**

Themelohet Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh. a. Podujevë, në këtë përbërje;

1. Avni Fetahu, kryesues, i emëruar nga Kryetari i Komunës
2. Mrikë Thaqi, anëtare, e emëruar nga radhët e Kuvendit të Komunës
3. Hasan Softolli, anëtar, i emëruar nga radhët e Kuvendit të Komunës

#### **Neni 2**

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

#### **Neni 3**

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-016-53823**  
**Podujevë,**  
**01 qershor 2015**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Mehmet Gashi**